



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Sektorët Kryesorë në Zhvillim Ekonomik të Kosovës: Një Perspektivë nga Rritja Reale e BPV

Prishtinë, 2024



Informacione rreth Analizës

Kjo analizë është bërë nga Oda Ekonomike e Kosovës në kuadër të Departamentit për Analiza dhe Komunikim Strategjik përfaqësuar nga autorja kryesore znj. Muela Ibrahim-Hamdiu me kontributet e znj. Shpresa Vokshi-Jupolli. Analiza ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë rreth dinamikave të zhvillimit të sektorëve të ekonomisë së Kosovës, identifikimit të sektorëve të rëndësishëm që kanë pasur rritje reale dhe ndikim të madh në zhvillim ekonomik, vlerësimin e kontributit në rritjen ekonomike, përcaktimin e tendencave dhe pjesëmarrjen e sektorëve në bruto produktin vendor.

Përmes analizës së sektorëve të ekonomisë synojmë të ofrojmë informacione që ndihmojnë Oden Ekonomike të Kosovës, në rolin e politik-bërësit dhe sektorin privat të kuptojnë sektorët që duhet të adresohen dhe mbështeten për të arritur një rritje ekonomike të qëndrueshme. Gjithashtu, ndihmon në marrjen e vendimeve strategjike për të bërë biznes dhe përcaktimin e sektorëve me potencial për rritje dhe investime.

Përmbajtje

Informacione rreth Analizës	2
Përmbledhje ekzekutive	4
1. Hyrja.....	6
2. Qëllimi dhe metodologjia.....	7
3. Analizë e Sektorëve të Ekonomisë së Kosovës.....	8
3.1. Aktivitetet ekonomike sipas pjesëmarrjes në BPV, 2021 – 2022.....	8
3.2. Sektorët me rritje reale më të lartë 2021-2022	9
3.3. Rritja reale sipas aktiviteteve ekonomike 2021-2022.....	10
3.4. Rritja reale sipas aktiviteteve ekonomike në tremujorin e parë, dytë dhe tretë të vitit 2023.....	11
3.5. Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale në përqindje.....	12
3.6. Rritja reale e Bruto Produktit Vendor ndërvite	14
Përfundimi dhe rekomandimet	15
References	16

Lista e figurave

Figura 1: Sektorë që kanë pjesëmarrje më të lartë në BPV e Kosovës gjatë vitit 2022, në përqindje.....	8
Figura 2: Sektorët me rritje reale më të lartë gjatë 2021-2022	10
Figura 3: Rritja reale sipas aktiviteteve ekonomike 2021-2022	10
Figura 4: Rritja reale sipas aktiviteteve ekonomike për tremujorin e parë, dytë dhe tretë të vitit 2023.....	12
Figura 5: Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale në përqindje TM3/2023.....	13
Figura 6: Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak	14

Lista e shkurtesave

BPV – Bruto Produkti Vendor
OEK – Oda Ekonomike e Kosovës
ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK – Agjencia Tatimore e Kosovës
BB – Banka Botërore

Përmbledhje ekzekutive

Ekonomia e vendit tregoi rritje vjetore më të lartë në vitin 2023 krahasuar me rritjen vjetore në tremujorin e kaluar të vitit 2022. Bazuar në të dhënat e fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), ekonomia e vendit në tremujorin e tretë shënoi rritje vjetore prej 3.0% në terma realë, dhe 8.0% në terma nominalë. Kjo rritje i atribuohet kryesisht konsumit (privat dhe publik) dhe investimeve, ndërsa eksporti neto ndikoi negativisht në këtë rritje.

Sipas të dhënave të Bankës Botërore, ekonomia e Kosovës ka përjetuar progres të qëndrueshëm ekonomik gjatë dekadës së fundit, me një rritje prej afro 50% të të ardhurave për kokë banori dhe një ulje prej 35% të shkallës së varfërisë. Ka kaluar me sukses nga një model rritjeje të bazuar në varësinë e lartë nga flukset hyrëse të ndihmave të huaja, duke tejkaluar vendet homologe me të ardhura të ngjashme për kokë banori falë një zgjerimi të vazhdueshëm të konsumit dhe investimeve, me një shtysë të fortë nga flukset hyrëse të diasporës, investimet publike në infrastrukturë, dhe thellimit financiar, në një pozicion fiskal të qëndrueshëm dhe një mjedisi me inflacion të ulët.

Kjo analizë ofron të dhëna rreth gjendjes aktuale dhe dinamikës së zhvillimit të sektorëve gjatë vitin 2021, 2022 dhe tre tremujoreve të vitit 2023. Duke ju referuar të dhënave të ASK, në tremujorin e tretë të vitit 2023 në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit 2022 kishin rritje aktivitetet ekonomike të edukimit me 29,84%, art, zbavitje dhe rekreacion me 14,44%, aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike me 8,70%, shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale (5,85%), aktivitetet financiare dhe të sigurimit (5,08%), Informimi dhe komunikimi (4,93%) dhe industria përpunuese me 3,18%. Ndërsa, aktivitetet që kanë pësuar rënie gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023 janë administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social (-5,56%) si dhe furnizimi me energji elektrike dhe gaz (-11,63%).

Bazuar në të gjeturat e analizës tonë nga përpunimi i të dhënave në formë të detajuar është evidentuar se industria përpunuese, informimi dhe komunikimi, dhe tregtia me shumicë dhe pakicë kanë pasur rritje reale më të madhe gjatë vitit 2021, 2022 dhe tre tremujoreve të vitit 2023, rrjedhimisht, këta sektor kanë kontribuar më shumë në rritjen ekonomike të vendit gjatë kësaj periudhe. Këto rezultate tregojnë një ambient të favorshëm pasi që sektorët që kanë shënuar rritje reale kanë një rëndësi të veçantë dhe janë sektor kyç të ekonomisë me potencial të madh për zhvillim dhe krijim të vendeve të reja të punës. Më tutje, është analizuar dhe pjesëmarrja e sektorëve në përqindje në BPV gjatë vitit 2022, ku tregtia me shumicë dhe pakicë përbëjnë 18% të BPV, pasuar nga industria përpunuese me 17%, ndërtimtaria 10% dhe bujqësia me 9%.

Zhvillime pozitive janë evidentuar dhe në sektorin e punësimit sipas të dhënave të ATK në tremujorin e tretë të vitit 2023, numri i të punësuarve është 5,9% më i lartë se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Kontributi më i madh në punësim vjen nga tregtia me shumicë dhe pakicë, industria përpunuese, aktivitetet financiare dhe të sigurimit dhe sektori i ndërtimit. Rritja e numrit të punëtorëve në sektorët e lartcekur është tregues kryesor i zhvillimit të këtyre sektorëve. Këto

rezultate dëshmojnë për trendët pozitive të punësimit dhe përcaktojnë sektorët që kanë kontribuar më shumë në hapjen e vendeve të reja të punës dhe rrjedhimisht në rritjen ekonomike.

Duke u mbështetur në të dhënat nga burimet sekondare dhe të dhënat e përpunuara të analizës tonë të detajuar mund të themi se sektorët që kanë kontribuar më shumë në rritjen ekonomike të Kosovës gjatë periudhës 2021 – 2023 janë industria përpunuese, tregtia me shumicë dhe pakicë, informimi dhe komunikimi, dhe aktivitetet financiare dhe të sigurimit. Megjithatë, është e rëndësishme të theksojmë se, pavarësisht performancës së mirë të këtyre sektorëve, rritja dhe zhvillimi i tyre nuk janë në përputhje me potencialin e tyre të plotë dhe zhvillimet në rajon. Prandaj, është e rëndësishme të hartohen stimuj të përshtatshëm për këta sektor me qëllim të stimulimit të zhvillimit të tyre të qëndrueshëm dhe përmirësimit të kapaciteteve të tyre konkurruese. Disa nga masat konkrete që mund të ndërmerren janë:

- **Krijimi i politikave të favorshme:** që inkurajojnë investimet e reja, ulin barrierat burokratike dhe ofrojnë insentiva fiskale për ndërmarrjet të përmirësojnë infrastrukturën, inovacionin dhe ndikojnë në rritjen e eksporteve;
- **Përkrahja e inovacionit dhe zhvillimit teknologjik:** ndërmarrja e hapave për të përmirësuar sistemin arsimor dhe përshtatjen e ofertës dhe kërkesës për punë me kurrikulat për të siguruar se fuqia punëtore është e kualifikuar dhe me aftësi të duhura për tregun e punës. Krijimi i skemave mbështetëse për ofrimin e granteve dhe financimin e projekteve inovative në sektorët e identifikuar që kanë pasur rritje reale;
- **Lehtësimi i tranzicionit të gjelbër:** hartimi i legjislacionit dhe politikave që lehtësojnë kalimin nga një ekonomi lineare në qarkore. Krijimi i skemave mbështetëse për ndërmarrjet që investojnë në teknologji të gjelbra dhe modele qarkore të prodhimit me qëllim të rritjes së kapacitetit prodhues. Krijimi i incentivave fiskale për ndërmarrjet që përdorin burime eficiente të riciklueshme dhe implementojnë praktika të gjelbra;
- **Lehtësimi i të bërit biznes:** rishikimi dhe përmirësimi i proceseve burokratike administrative që vështirëson operimin e bizneseve. Promovimi i partneritetit publiko-privat për të ndihmuar zbatimin e politikave. Krijimi i një platforme bashkëpunuese për dialogun dhe bashkëpunimin midis sektorit publik dhe privat për të adresuar sfidat dhe për të implementuar politikat efikase.

Ndërmarrja e hapave të mësipërm krijon një bazë të qëndrueshme për të përmirësuar konkurrencën dhe rritjen e sektorëve kyçë në ekonominë e Kosovës. Ndërsa, një fokus i veçantë në tranzicionin drejt ekonomisë së gjelbër do të sjellë përfitime afatgjata për mjedisin dhe do të përmirësojë qëndrueshmërinë e sektorëve të ndryshëm ekonomikë në Kosovë. Kombinimi i këtyre masave do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe në avancimin e pozicionit konkurrues të vendit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

1. Hyrja

Ekonomia globale shënoi një performancë jo të kënaqshme gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023, duke evidentuar një rritje ekonomike të ngadalësuar. Ngadalësimi në aktivitetin ekonomik ishte veçanërisht i theksuar në sektorin e shërbimeve, ndërsa edhe aktiviteti i prodhimit mbeti ende i ulët. Rikuperimi në tregtinë globale vazhdoi, megjithatë të dhënat e fundit sugjerojnë se tendenca e rritjes mund të jetë më e dobët në tremujorët në vazhdim, në përputhje me ngadalësimin në aktivitetin ekonomik. Presionet mbi inflacion shënuan një rritje të lehtë në fund të këtij tremujori, duke reflektuar rritjen e çmimeve të energjisë, ndërsa inflacioni bazë tregoi tendenca ulëse (Financial Times). Ani pse ekonomia botërore shënoi një rritje të ngadalësuar, në tremujorin e tretë të vitit 2023, Ekonomia e SHBA-ve përformoi më mirë se sa parashihej duke treguar qëndrueshmëri përkundër normave të larta të interesit. (European Center Bank, n.d.)

Ky raport ka për qëllim të ofrojë një analizë të thelluar të aktiviteteve ekonomike të vendit gjatë periudhës 2021-2022 dhe tremujorëve TM1, TM2 dhe TM3 të vitit 2023. Në këtë analizë, ne kemi synuar të identifikojmë sektorët me zhvillim më të lartë ekonomik, duke përfshirë aspektet e dinamikës së zhvillimit, rritjes reale ndër vite dhe pjesëmarrjes në Bruto Produktin Vendor (BPV). Duke marr parasysh nevojën e OEK-ut dhe komunitetit të biznesit për identifikimin e sektorëve që kanë pasur performancë më të mirë. Identifikimi i këtyre sektorëve do të ndihmojë në përcaktimin e fushave me potencial më të lartë për rritje dhe zhvillim ekonomik. Analiza është bazuar në një metodologji të kombinuar të metodës kualitative dhe kuantitative nga të dhënat sekondare, duke përfshirë analizë të hollësishme të të dhënave të bruto produktit vendor, aktiviteteve ekonomike, kontributit të aktiviteteve ekonomike në BPV dhe rritjen reale të sektorëve. Burimet kryesore të të dhënave përfshijnë raportet e sektorëve të ndryshëm, raportet e institucioneve financiare, dhe të dhënat zyrtare të ASK-së.

Nëpërmjet analizës së këtyre të dhënave, kemi identifikuar sektorët që kanë treguar performancë të lartë ekonomike në periudhën e studiuar. Këto sektorë përfshijnë, por nuk kufizohen në, industrinë përpunuese, informimin dhe komunikimin, dhe tregtia me shumicë dhe pakicë. Rritja e tyre është vlerësuar duke përdorur kritere të ndryshme, duke përfshirë normën e rritjes reale, kontributin e tyre në BPV, dhe pjesëmarrjen në BPV. Kuptimi i dinamikave të këtyre sektorëve do të ndihmojë në përcaktimin e politikave efikase dhe në përmirësimin e qëndrueshmërisë së zhvillimit ekonomik.

Bazuar në gjetjet e analizës, ofrojmë rekomandime konkrete për të përmirësuar situatën ekonomike dhe për të fokusuar resurset dhe fondet në sektorët me potencial më të lartë për rritje dhe kontribut në zhvillimin ekonomik të vendit. Këto rekomandime janë të orientuara drejt përmirësimit të klimës së investimeve dhe stimulimit të inovacionit në sektorët kyç.

Raporti është si strukturuar si në vijim: Fillimisht, qëllimi dhe metodologjia është përshkruar, pastaj është ndjekur nga analiza e sektorëve të ekonomisë së Kosovës. Ky raport përfundon me një vlerësim të përgjithshëm të situatës ekonomike, implikimet dhe rekomandimet për akterët e ndryshëm.

2. Qëllimi dhe metodologjia

Qëllimi i këtij raporti është të ofroj një pasqyrë rreth dinamikave të zhvillimit të sektorëve të ekonomisë së Kosovës, identifikimit të sektorëve të rëndësishëm që kanë pasur rritje reale dhe ndikim të madh në zhvillim ekonomik, vlerësimin e kontributit në rritjen ekonomike, përcaktimin e tendencave dhe pjesëmarrjen e sektorëve në bruto produktin vendor.

Metodologjia e këtij studimi është konceptuar duke përdorur një qasje të kombinuar të metodave kualitative dhe kuantitative, përmes analizës së të dhënave sekondare. Përdorimi i kësaj metodologjie të kombinuar ka pasuar një qasje holistike në shqyrtimin e aktiviteteve ekonomike, bruto produktit vendor (BPV), dhe performancës së sektorëve gjatë periudhës 2021-2023. Kjo qasje ka lejuar një kuptim të thelluar të dinamikave dhe zhvillimeve në sektorët kyç.

Përdorimi i një metodologjie të kombinuar është bërë me qëllim të përfshirjes së perspektivave të metodave kualitative dhe kuantitative. Metodave kualitative janë përdorur për të kuptuar kontekstin dhe ndërveprimet në sektorë, ndërsa ato kuantitative janë përdorur për të siguruar një vështrim objektiv të bazuar në numra mbi performancën ekonomike. Ë dhënat sekondare janë përdorur si burim kryesor për analizën. Këto përfshijnë raportet e sektorëve të ndryshëm, dokumentacionin e institucioneve financiare, dhe të dhënat zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Analiza është bazuar në të dhëna të Bruto Produktit Vendor për të vlerësuar kontributin e sektorëve në ekonominë vendase. Kjo ka ofruar një bazë të qëndrueshme për vlerësimin e rritjes reale dhe pjesëmarrjes së tyre në BPV. Në bazë të të dhënave të disponueshme, kemi formuluar një përcaktim të qartë dhe analitik për secilin sektor që ka shfaqur një tendencë pozitive të rritjes reale në këtë periudhë. Përmes metodës krahasuese të të dhënave, kemi identifikuar sektorët me performancë më të lartë, duke përfshirë industrinë përpunuese, informimin dhe komunikimin, si dhe tregtinë me shumicë dhe pakicë.


3. Analizë e Sektorëve të Ekonomisë së Kosovës


3.1. Aktivitetet ekonomike sipas pjesëmarrjes në BPV, 2021 – 2022

Në figurën 1 është analizuar pjesëmarrja e aktiviteteve ekonomike (sektorëve) në përqindje në BPV në vitin 2022. Në bazë të të dhënave të paraqitura në figurë, vërehet se pjesëmarrja më e lartë në BPV gjatë vitit 2022 ka pasur sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë, duke arritur në 18% të totalit të BPV. Pas këtij sektori, pason industria përpunuese me 17%, ndërtimtaria me 10%, bujqësia dhe pylltaria me 9%, dhe afarizmi me pasuri të patundshme me 8%.

Këto rezultate demonstrojnë një shpërndarje të ndryshme të përqindjes së sektorëve në kontributin e tyre në BPV gjatë vitit 2022.

Figura 1: Sektorë që kanë pjesëmarrje më të lartë në BPV e Kosovës gjatë vitit 2022, në përqindje






Burimi: Analiza e zhvillimit të sektorëve, Oda Ekonomike e Kosovës

3.2. Sektorët me rritje reale më të lartë 2021-2022

Figura e mëposhtme ofron një pasqyrë të performancës së disa sektorëve kyçë gjatë periudhës 2021 – 2022 duke përmirësuar kuptimin e dinamikave të rritjes ekonomike. Sipas rezultateve të paraqitura në figurën 2, mund të konkludojmë se sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë ka pasur normën më të lartë të rritjes reale me 19% në vitin 2021 dhe 11% në vitin 2022. Poashtu, industria përpunuese gjatë vitin 2022 pati një rritje reale prej 10% ndërsa në vitin paraprak një rritje të ngjashme prej 11%. Ky rezultat reflekton stabilitetin dhe ndikimin pozitiv të këtij sektori në ekonominë vendase. Sektori i aktiviteteve administrative dhe mbështetëse ka shfaqur një rritje reale prej 7% në vitin 2022, ndërsa kishte një rritje prej 9% në vitin 2021. Sektori i informimit dhe komunikimit ka shënuar një rritje reale prej 9% në vitin 2022 krahasuar me vitin paraprak ku kishte një rritje prej 4%. Ky ndryshim pozitiv konfirmon rolin e këtij sektori si një ndër motorët kryesorë të rritjes në ekonominë aktuale.

Figura 2: Sektorët me rritje reale më të lartë gjatë 2021-2022




Burimi: Analiza e zhvillimit të sektorëve, Oda Ekonomike e Kosovës

3.3. Rritja reale sipas aktiviteteve ekonomike 2021-2022

Figura e mëposhtme prezanton normën e rritjes reale të aktiviteteve ekonomike për vitin 2021 dhe 2022. duke hedhur dritë mbi lëvizjet dhe ndryshimet në performancën e sektorëve gjatë këtyre dy viteve. Në bazë të rezultateve, në shumicën e sektorëve, ndryshimet në normën e rritjes reale nuk duket të jenë shumë të signifkante në mes të vitit 2021 dhe 2022, përveç në sektorin e transportit dhe magazinimit dhe ndërtimit ku kemi një rënie të normës reale të rritjes.. Ky kontinuitet tregon për një stabilitet të përgjithshëm në performancën ekonomike.

Figura 3: Rritja reale sipas aktiviteteve ekonomike 2021-2022



Burimi: Analiza e zhvillimit të sektorëve, Oda Ekonomike e Kosovës

3.4. Rritja reale sipas aktiviteteve ekonomike në tremujorin e parë, dytë dhe tretë të vitit 2023


Rritje më e lartë reale përgjatë TM1, TM2 dhe TM3 të vitit 2023 është evidentuar në aktivitetet ekonomike si në vijim, arti, zbavitja dhe rekreacioni 12%, pasuar nga aktivitetet profesionale,

shkencore dhe teknike me 9%. Sektorët e edukimit dhe aktiviteteve financiare dhe të sigurimit kanë prezantuar një rritje reale prej 7% gjatë këtyre tremujorëve.

Rritja reale në “Art, zbavitje dhe rekreacion” tregon për një rritje të interesit dhe kërkesës për shërbime kulturore dhe argëtuese, njëkohësisht dhe hapjen e televizioneve të reja. Sektori i aktiviteteve profesionale, shkencore dhe teknike ka vazhduar me një performancë të kënaqshme, duke shënuar një rritje reale prej 9%. Ky tregues mund të lidhet me zhvillime të reja në fushën e shkencës dhe teknologjisë, si dhe kërkesë të lartë për shërbime profesionale.

Këto shifra tregojnë për një diversifikim të rritjes së sektorëve ekonomikë gjatë tremujorëve të vitit 2023.

Figura 4: Rritja reale sipas aktiviteteve ekonomike për tremujorin e parë, dytë dhe tretë të vitit 2023




Burimi: Analiza e zhvillimit të sektorëve, Oda Ekonomike e Kosovës

3.5. Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale në përqindje

Figura 5 paraqet strukturën e Bruto Produktit Vendor (BPV) sipas aktiviteteve ekonomike për tremujorin e tretë të vitit 2023, duke përdorur çmimet aktuale. Analiza e këtyre të dhënave jep një pamje të përgjithshme të performancës së sektorëve në këtë periudhë specifike. Sektori i edukimit ka shënuar një rritje të dukshme në BPV gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023. Kjo mund t'i atribuohet investimeve në arsim dhe aftësimin e fuqisë punëtore. Sektori i informacionit dhe

komunikimit gjithashtu ka shënuar një rritje në pjesën e tij në BPV, që tregon zhvillimet në teknologji dhe nevojën për shërbime të lidhura me komunikimin. Sektorët tjerë që patën rritje gjatë TM3 janë: Art, zbavitje dhe rekreacion, Shëndetësi, Industria nxjerrëse, Bujqësia pylltaria dhe peshkimi.

Figura 5: Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike me cmime aktuale në përqindje TM3/2023




Burimi: Statistikat e Llogarive Kombëtare Bruto Produkti Vendor, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

3.6. Rritja reale e Bruto Produktit Vendor ndërvite

Në figurën 9 ofron një pasqyrë të BPV përgjatë periudhës 2021 – 2023. Në bazë të të dhënave të prezantuara në figurë vërehet një rritje reale e BPV-s prej 3% krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Nëse i shikojmë të dhënat nder vite, vërejmë një tendencë të rritjes reale të ngadalshme që nga tremujori i dytë i vitit 2022. Kjo tregon për një rritje të stabile, megjithatë, me një temp të moderuar në ekonominë vendase.

Figura 6: Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak



Burimi: Statistikat e Llogarive Kombëtare Bruto Produkti Vendor, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Përfundimi dhe rekomandimet

Bazuar në analizën tonë të detajuar dhe në të dhënat nga burimet sekondare, mund të themi se sektorët që kanë kontribuar më shumë në rritjen ekonomike të Kosovës gjatë periudhës 2021 – 2023 janë industria përpunuese, tregtia me shumicë dhe pakicë, informimi dhe komunikimi, dhe aktivitetet financiare dhe të sigurimit. Megjithatë, është e rëndësishme të theksojmë se, pavarësisht performancës së mirë të këtyre sektorëve, rritja dhe zhvillimi i tyre nuk janë në përputhje me potencialin e tyre të plotë dhe zhvillimet në rajon.

Disa nga rekomandimet konkrete janë:

- Krijimi i politikave të favorshme: që inkurajojnë investimet e reja, ulin barrierat burokratike dhe ofrojnë insentiva fiskale për ndërmarrjet të përmirësojnë infrastrukturën, inovacionin dhe ndikojnë në rritjen e eksporteve.
- Përkrahja e inovacionit dhe zhvillimit teknologjik: ndërmarrja e hapave për të përmirësuar sistemin arsimor dhe përshtatjen e ofertës dhe kërkesës për punë me kurrikulat për të siguruar se fuqia punëtore është e kualifikuar dhe me aftësi të duhura për tregun e punës. Krijimi i skemave mbështetëse për ofrimin e granteve dhe financimin e projekteve inovative në sektorët e identifikuar që kanë pasur rritje reale.
- Lehtësimi i tranzicionit të gjelbër: hartimi i legjislacionit dhe politikave që lehtësojnë kalimin nga një ekonomi lineare në qarkore. Krijimi i skemave mbështetëse për ndërmarrjet që investojnë në teknologji të gjelbra dhe modele qarkore të prodhimit me qellim të rritjes së kapacitetit prodhues. Krijimi i incentivave fiskale për ndërmarrjet që përdorin burime eficiente të riciklueshme dhe implementojnë praktika të gjelbra.
- Lehtësimi i të bërit biznes: rishikimi dhe përmirësimi i proceseve burokratike administrative që vështirëson operimin e bizneseve. Promovimi i partneritetit publiko-privat për të ndihmuar zbatimin e politikave. Krijimi i një platforme bashkëpunuese për dialogun dhe bashkëpunimin midis sektorit publik dhe privat për të adresuar sfidat dhe për të implementuar politikat efikase.

Përmes këtyre masave, synohet të krijohet një mjedis të favorshëm për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe për të përmirësuar konkurrencën e sektorëve kyçë në ekonominë e Kosovës. Në veçanti, një fokus i veçantë në tranzicionin drejt ekonomisë së gjelbër do të sjellë përfitime afatgjata për mjedisin dhe do të përmirësojë qëndrueshmërinë e sektorëve të ndryshëm ekonomikë në Kosovë. Kombinimi i këtyre masave do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe në avancimin e konkurrencës së vendit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

References

European Center Bank. (a.d.). Gjetur në

<https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/ecbu/eb202307.en.pdf>.

ASK. (a.d.). *BPV*. Gjetur në [https://askapi.rks-gov.net/Custom/7be58c36-5f25-468e-8ec1-](https://askapi.rks-gov.net/Custom/7be58c36-5f25-468e-8ec1-b509e0ecea95.pdf)

[b509e0ecea95.pdf](https://askapi.rks-gov.net/Custom/7be58c36-5f25-468e-8ec1-b509e0ecea95.pdf).

ASKdata.rks. (a.d.). *ASKdata.rks*. Gjetur në Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me

çmime aktuale, 2010TM1 - 2023TM3: [https://askdata.rks-](https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__National%20and%20government%20accounts__National%20accounts__Quarterly%20national%20accounts/BPV_Current02.px/)

[gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__National%20and%20government%20accounts__National%20accounts__Quarterly%20national%20accounts/BPV_Current02.px/](https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__National%20and%20government%20accounts__National%20accounts__Quarterly%20national%20accounts/BPV_Current02.px/)

BQK. (a.d.). *bqk-kos.org*. Gjetur në ÇKA ËSHTË BRUTO PRODUKTI VENDOR?: [https://bqk-](https://bqk-kos.org/edu/wp-content/uploads/2021/08/cka-eshte-Bruto-Produkti-Vendor-7.pdf)

[kos.org/edu/wp-content/uploads/2021/08/cka-eshte-Bruto-Produkti-Vendor-7.pdf](https://bqk-kos.org/edu/wp-content/uploads/2021/08/cka-eshte-Bruto-Produkti-Vendor-7.pdf)

Financial Times. (a.d.). Gjetur në US economic growth accelerated in third quarter:

<https://www.ft.com/content/8409fd04-90f4-490b-af08-c9b67a36077c>

KOSOVES, B. B. (a.d.). *BANKA BOTERORE E KOSOVES*. Global Economic Prospects:

<https://openknowledge.worldbank.org/collections/09c5e8fc-187f-5c2f-a077-3e03044c7b62>